



INSTITUTI KAF ©IKAF

Syllabus

2019

Syllabus

Teknik i Kontabilitetit

Zhvillo karrieren me IKAF

Teknik i Kontabilitetit i Certifikuar

Teknikët e Kontabilitetit kanë një rol shumë të rëndësishëm për të gjitha ndërmarrjet, që nga bizneset private të reja, departamentet qeveritare e deri te korporatat. Teknikët e Kontabilitetit u ndihmojnë kontabilistëve profesionistë për të mbledhur, kontrolluar dhe analizuar informacionet financiare.

Kualifikimi për Teknik të Kontabilitetit është i dizajnuar në atë mënyrë që nevojitet njohuri nga kontabiliteti, por jo ndonjë përvojë relevante në këtë fushë. Ky është një kualifikim zhvillues për menaxherët e zyrës si dhe për stafin administrativ, po ashtu, një bazë e pa evitueshme për ata që duan të kualifikohen si kontabilistë të certifikuar.



Skema e Moduleve të Nivelit Teknik i Kontabilitetit

Moduli TK-F1 Kontabilisti në Biznes	▪ Organizimi i biznesit, precedentët e biznesit, dhe mjedisi i jashtëm; ▪ Struktura biznesore organizacionale, funksionet dhe qeverisja; ▪ Sistemet e kontabilitetit dhe raportimit, kontrollit dhe pajtueshmërisë; ▪ Udhëheqja dhe menaxhimi i ekipeve dhe individëve; ▪ Komunikimi dhe efikasiteti personal; ▪ Etika profesionale në kontabilitet dhe biznes.
Moduli TK - F2 Kontabiliteti Menaxherial	▪ Natyra, burimi dhe qëllimi i informacionit menaxherial ▪ Teknikat e Kontabilitetit të kostos ▪ Buxhetimi ▪ Kostimi standard ▪ Matja e performancës
Moduli TK - F3 Kontabiliteti Financiar	▪ Konteksti dhe qëllimi i raportimit financiar ▪ Karakteristikat cilësore të informacionit financiar ▪ Përdorimi i hyerjes së dyfishtë dhe sistemet e kontabilitetit ▪ Regjistrimi i transaksioneve dhe ngjarjeve ▪ Përgatitja e testeve (suksesionit, vargut) ▪ Përgatitja e pasqyrave bazike financiare ▪ Përgatitja e pasqyrave të thjeshta të konsoliduara financiare ▪ Interpretimi i pasqyrave financiare
Moduli TK - F6 Tatimet	▪ Shoqëritë tregtare, ▪ Administrata tatimore dhe procedurat, ▪ Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), ▪ Dogana dhe akciza, ▪ Tatimi mbi të ardhurat e korporatave, ▪ Kërkesat ligjore për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare.

Moduli

TK-F1 KONTABILISTI NË BIZNES

15 Kredi

Objektivat

Objektivë themelore është kuptimi i njohurive dhe domethënies së biznesit dhe mjedisit të tij dhe ndikimi që ka në strukturën organizative. Kuptimi i rolit të kontabilitetit dhe funksioneve tjera kyçe të bizneseve në dhënien e kontributit në menaxhimin dhe zhvillimin efikas, efektiv dhe etik në një organizatë, njerëzve dhe sistemeve të saj. Objektivat tjera janë si në vijim:

- ❖ Kuptimi i qëllimit dhe llojeve të bizneseve dhe se si dhe ndërveprimi me grupet kryesore të interesit dhe mjedisin e jashtëm
- ❖ Kuptimi i strukturës organizative të biznesit, funksionin dhe rolin e qeverisjes korporative;
- ❖ Njohja e funksioneve të kontabilitetit dhe auditimit në komunikim, raportim dhe sigurimin e informatave financiare dhe në kontrollin efektiv financiar dhe pajtueshmërinë;
- ❖ Njohja e parimeve të autoritetit dhe lidërshit dhe se si ekipet dhe individët rekrutohen, menaxhohen, motivohen dhe zhvillohen;
- ❖ Kuptimi i rëndësisë së efektivitetit personal si bazë për ekipin efektiv dhe sjelljes organizative.

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Organizimi i biznesit, precedentët e biznesit, dhe mjedisi i jashtëm;
- ❖ Struktura biznesore organizacionale, funksionet dhe qeverisja;
- ❖ Sistemet e kontabilitetit dhe raportimit, kontrollit dhe pajtueshmërisë;
- ❖ Udhëheqja dhe menaxhimi i ekipeve dhe individëve;
- ❖ Komunikimi dhe efikasiteti personal;
- ❖ Etika profesionale në kontabilitet dhe biznes.



Karakteristikat e Ligjërës Trajnuese:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Kontabilisti në Biznes F1 - gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërate, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

TK-F2 Kontabiliteti Menaxherial

15 Kredi

Objektivat

Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të duhura për një menaxher financiar në lidhje me investimet, financat dhe vendimet mbi politikën e dividendit; më detajisht:

- ❖ Shtjellimi i rolit dhe qëllimit të funksionit të menaxhimit financiar
- ❖ Analizmi dhe vlerësimi i ndikimit të mjedisit ekonomik në vendimarrje
- ❖ Analizimi dhe aplikimi i teknikave të kapitalit punues, si dhe realizimi i vlerësimeve efikase të investimeve
- ❖ Identifikimi i burimeve të financave të biznesit
- ❖ Sqarimi dhe kalkulimi i koston së kapitalit, dhe faktorët që ndikojnë në këtë kosto
- ❖ Njohja e parimeve të biznesit, diskutimi dhe aplikimi i tyre
- ❖ Sqarimi dhe diskutimi i teknikave të menaxhimit të rrezikut

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Natyra, burimi dhe qëllimi i menaxhimit të informacionit
- ❖ Teknikat e Kontabilitetit të Kostos
- ❖ Buxhetimi
- ❖ Kosto Standarde
- ❖ Matja e Performances



Karakteristikat e Ligjërës Trajnuese:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Kontabiliteti Menaxherial F2 - gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërë, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

TK-F3 Kontabiliteti Financiar

15 Kredi

Objektivat

Objektivë kryesore është rritja e njohurive dhe kuptimi i parimeve themelore dhe koncepteve të ndërlidhura me kontabilitetin financiar dhe aftësitë teknike në përdorimin e teknikave të kontabilitetit të dyfishtë duke përfshirë përgatitjen dhe pasqyrave financiare themelore për biznese. Gjithashtu, prezantimi i teknikave bazike të interpretimit të pasqyrave financiare. Objektivat e detajuara:

- ❖ Sqarimi i hapësirës dhe qëllimit të raportimit financiar
- ❖ Definimi i karakteristikave cilësore të informatave financiare
- ❖ Demonstrimi dhe përdorimi i kontabilitetit të dyfishtë dhe sistemeve të kontabilitetit
- ❖ Regjistrimi i transaksioneve dhe ngjarjeve
- ❖ Përgatitja e bilancit vërtetues (identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve)
- ❖ Përgatitja e pasqyrave financiare për bizneset dhe organizatat jo-profitabile
- ❖ Praktikimi i interpretimit bazik i pasqyrave financiare
- ❖ Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Konteksti dhe qëllimi i raportimit financiar,
- ❖ Karakteristika cilësore të Informacionit financiar dhe bazat themelore të kontabilitetit,
- ❖ Përdorimi i hyrjes së dyfishtë dhe sistemet e kontabilitetit,
- ❖ Regjistrimi i transaksioneve dhe ngjarjeve,
- ❖ Përgatitja e testeve (suksesionit, vargut),
- ❖ Përgatitja e Pasqyrave bazike Financiare.



Karakteristikat e Ligjëratës Trajnuese:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Kontabiliteti Financiar F3; dhe gjatë ligjëratës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Plan-programi trajnues është i bazuar në plan-programet ACCA.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërate, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.

Moduli

TK-F6 Tatimet

15 Kredi

Objektivat

Objektivi themelor ka të bëjë me zhvillimin njohurive dhe të kuptohen llojet e shoqërive tregtare, klasifikimi i tyre sipas ARBK-së, ATK-së dhe KKRF-së, si dhe aftësitë tekniko-fiskale duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare themelore. Më detajisht:

- ❖ Kuptimi i llojeve të bizneseve
- ❖ Kuptimi i procedurave tatimore
- ❖ Kuptimi tatimit mbi vlerën e shtuar
- ❖ Kuptimi i doganave dhe akcizave
- ❖ Kuptimi i tatimit mbi të ardhurat personale
- ❖ Kuptimi i tatimit mbi të ardhurat e korporatave
- ❖ Kuptimi i kërkesave ligjore për raportim/auditim të pasqyrave financiare

Temat që do të trajtohen:

- ❖ Shoqëritë tregtare
- ❖ Administrata tatimore dhe procedurat
- ❖ Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)
- ❖ Dogana dhe Akciza
- ❖ Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)
- ❖ Tatimi mbi të ardhurat e korporatave (TAK)
- ❖ Kërkesat ligjore për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave



Karakteristikat e Ligjërës Trajnuese:

- ✓ Rishikimi i përgjithshëm i librit Tatimet F6; dhe gjatë ligjërës, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm, dhe shembuj të provimeve.
- ✓ Ligjëruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjërimit.
- ✓ Në përfundim të kësaj ligjërë, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendrën e Institutit KAF.